

# PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË FERIZAJT

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË FERIZAJ ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





# PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

**ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.”** Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-rra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



# PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi inicohet dhe derivohehet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





# OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN  
TË ARRIHEN:

1

Përfshirje e drejtpërdrejt e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja e këtyre propozimeve ose jo nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Që të rritet komunikimi ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.

# Prioritetet e identifikuarra janë:

# 1

## SEKTORI I ARSIMIT



### Problemet e identifikuarra:

Grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim nga fusha e arsimit në komunë të cilat duhet të adresohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale me qëllim të përmirësimit të cilësisë në këtë fushë: Mungesa e kontrollit sistematik shëndetësor për nxënës të shkollës fillore dhe atyre të mesme.

Mungesa e objektit për shkollën e mjekësisë. Mungesa e cilësisë në shkollat profesionale – mungesë e perspektivës për nxënësit e diplomuar. Mungesa e kabineteve për punë praktike në shkollën teknike është një tjetër problem që duhet të trajtohet. Mungesa e sigurisë në nivelin e duhur në shkolla dhe rritja e shqetësimit për përdorim të substancave narkotike. Mungesa e sallave për edukatë fizike nëpër shkolla. Mungesa e higjienës në shumë objekte shkollore.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet komunale ta adresojnë me prioritet çështjen e kontrollit të rregullt mjekësor për nxënës të shkollave fillore dhe atyre të mesme me qëllim të identifikimit me kohë të problemeve eventuale shëndetësore. Po ashtu, për nxënës të klasave të teta dhe nënta në fillore dhe atyre në shkolla të mesme të sigurohet edhe konsultimi me psikologun në baza të rregullta. Drejtoritë relevante të krijojnë databazën e të dhënave me qëllim të përcjelljes së gjendjes së nxënësve. Për psikologët, një opsion i mundshëm mund të ishte angazhimi i studentëve të diplomuar nga fusha gjegjëse dhe të njëjtit të stimulohen në forma të caktuara.

**2** Autoritetet komunale të gjejnë mundësi për ndërtimin e objektivit të shkollës së mjekësisë. Vijueshmëria e mësimit nga nxënësit e gjimnazit dhe shkollës së mjekësisë në të njëjtin objekt shkollor ndikon shumë në nivelin e cilësisë së mësimit. Është e domosdoshme që objekti për shkollën e mjekësisë të ndërtohet sa më parë.

**3** Niveli jo i mirë i cilësisë së arsimit në shkollat profesionale duhet të adresohet me prioritet nga ana e autoriteteve lokale. Pajisja e shkollave me kabinete gjegjëse që u mundëson nxënësve kryerjen e punës

praktike, ngritja e nivelit të përgjegjësisë së menaxhmentit të shkollave mund të jenë opsione që do ndihmonin adresimin e këtij problemi. Po ashtu, autoritete lokale duhet të gjejnë mundësi për ndërmjetësimin e komunikimit të kuadrove nga këto shkolla me tregun e punës (sektorin privat).

**4** Autoritetet komunale duhet ta trajtojnë me prioritet edhe sigurinë në shkolla. Prania më e shpeshtë e policëve nëpër shkolla, ngritja e bashkëpunimit në mes të komunës, shkollave dhe këshillave të prindërve mund të ndihmojnë në këtë drejtim. Po ashtu, vendosja e alarmeve në tualete në shkolla do të mund të parandalonte konsumimin e substancave narkotike, derisa ka indikacione që diçka e tillë është dukuri prezentë.

**5** Autoritetet komunale të adresojnë problemin e mungesave të sallave për edukatë fizike nëpër shkolla.

**6** Për të siguruar qasje më të mirë ndaj higjienës por jo vetëm, kërkohet bashkëpunim në mes të inspektoratit për arsim dhe menaxhmenteve të shkollave. Ngritja e vetëdijes së nxënësve për higjienë duhet të jetë angazhim permanent i mësuesve.



# 2

## SEKTORI I SHËNDETËSISË



### Problemet e identifikuara:

Në fushën e shëndetësisë, grupi i të rinjve ka diskutuar gjendjen në Qendrat e Mjekësisë familjare, kompetencë e nivelit lokal, dhe ka identifikuar problemet në vijim që propozohen të trajtohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale: Mungesa e barnave esenciale në Qendrat e Mjekësisë Familjare paraqet një problem serioz për shumë qytetarë që detyrohen të gjejnë vetë zgjidhje.

Mungesa e etikës profesionale nga stafi i qendrave - jo rrallë qytetarët ballafaqohen me dukuri të tillë. Ka mjaft raste ku evidentohet mungesa e personelit shëndetësor në zonat rurale - mosrespektim i orarit të punës. Mungesa e higjienës në nivelin e duhur.







# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Sigurimi i shërbimeve cilësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare për qytetarët është esenciale meqë janë edhe institucioni i parë shëndetësor tek i cili ata drejtohen për të kërkuar trajtim.

**2** Autoritetet lokale duhet të adresojnë çështjen e mungesës së barnave në Qendra të Mjekësisë. Për të evituar mundësinë e keqpërdorimeve, që mund të jetë shkaktar i mungesës, mund të krijohet dhe mirëmbahet një databazë online ku do të regjistrohen të gjitha barnat që merren nga Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe kjo databazë do të mirëmbahet nga drejtoria komunale për shëndetësi. Po ashtu, autoritete lokale duhet të insistojnë tek niveli qendror që furnizimi me barna esenciale të jetë prioritet i vazhdueshëm

**3** Është e domosdoshme që autoritetet komunale të adresojnë problemin e mungesë së etikës profesionale si dhe mosrespektimin e orarit të punës në zonat rurale. Me praninë më të shpeshtë të inspektorëve shëndetësor si dhe me vendosjen e kutive të ankesave në secilën qendër, mund të adresohen të dy problemet.

**4** Po ashtu, shtimi i inspektimit të qendrave si dhe instalimi i kriterëve për kërkim llogarie, do të adresonte edhe problemin e mungesës së higjienës nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare.





# 3

## SEKTORI I RINISË



### Problemet e identifikuara:

Ligji për Fuqizimin e Rinisë dhe Strategjia për të rinjtë 2013-2017, përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale kundrejt krijimit të hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore. Objektivat strategjike të përcaktuara në Strategjinë për të rinjtë synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 Pjesëmarrja e të rinjve i Strategjisë së Kosovës për të rinjtë 2013-2017).

Grupi i të rinjve, mbështetur në këto objektiva ka identifikuar çështjet në vijim si prioritete që duhen trajtuar nga ana e autoriteteve lokale me qëllim të përmirësimit të ambientit të përgjithshëm në komunë që do të mundësonte përfshirjen më të madhe dhe aktivizimin e të rinjve në jetën publike: Mungesa e kinemasë në qytet. Mungesa e shfaqjeve teatrale. Mungesa e aktiviteteve rinore në sport dhe kulturë. Ndërprerja e aktivitetit për nxënës të shkollave të mesme i njohur si 'debati i nxënësve.' Politizimi i qendrës rinore. Mungesë e stimulimit për punën vullnetare të të rinjve.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Krijimi i kushteve për përfshirje të të rinjve në aktivitete të ndryshme si dhe në procesin e bërjes së politikave lokale duhet të jetë prioritet i vazhdueshëm për autoritete lokale.

**2** Autoritetet lokale të trajtojnë me prioritet funksionalizimin e kinemasë së qytetit dhe organizimin më të shpeshtë të shfaqjeve teatrale. Mungesa e kinemasë dhe shfaqjeve teatrale ndikojnë drejtpërdrejt në mungesën e aktiviteteve kulturore në komunë.

**3** Po ashtu, autoritetet lokale duhet të trajtojnë me prioritet edhe organizimin e aktiviteteve sportive për të rinjtë si dhe aktivitete kulturore siç janë festivalet. Sektori gjegjës komunal duhet të jetë shumë më i angazhuar dhe më proaktiv në nxitjen dhe përkrahjen e aktiviteteve sportive duke u koordinuar me grupet formale (OJQ-të) dhe jo formale të të rinjve.

**4** Autoritetet duhet me prioritet të mbështesin dhe financojnë projektin e 'debatit' për nxënës të shkollave të mesme – vitin e kaluar në mungesë mjetesh të ndara nga komuna, nxënësit nga Ferizaj nuk kanë marrë pjesë në këtë aktivitet. Përveç tjerash, ky aktivitet paraqet një mundësi shumë të mirë për pjesëmarrësit që të testojnë nivelin e diturisë por edhe të njihen dhe ndërveprojnë apo komunikojnë me nxënës nga qytetet tjera të vendit.

**5** Është urgjente depolitizimi i qendrës rinore. Autoritetet lokale të vendosin që qendra rinore të menaxhohet nga të rinjtë pa anime politike dhe e njëjta të i shërbej qëllimit elementar të saj – krijimit të hapësirës dhe mundësive për aktivitete për të rinjtë.

**6** Autoritete lokale duhet të nxjerrin vendimin/ rregulloren për implementim të Udhëzimit Administrativ për njohjen e punës vullnetare me qëllim të nxitjes dhe promovimit të vullnetarizmit tek të rinjtë. Autoritetet lokale mund të nxisin të rinjtë në vullnetarizëm përmes formave si në vijim: lirim në bileta për kinema, transport publik, bibliotekë qyteti etj., për të rinjtë që angazhohen në aktivitete vullnetare. Pa dyshim, autoritetet lokale do të përfitojnë duke përfshirë të rinjtë vullnetarë në aktivitete dhe punë me karakter publik që organizohen nga autoritetet lokale. Autoritetet lokale mund të pajisin Qendrën rinore me kompetencë për të organizuar dhe koordinuar punët me vullnetarizëm duke regjistruar gjithë vullnetarët e rinj, duke i pajisur ata me kartela identifikimi, dhe bashkë me drejtorinë komunale gjegjëse të krijojë një databazë të vullnetarëve.





# SEKTORI I AMBIENTIT / INFRASTRUKTURË



## Problemet e identifikuara:

Në fushën e ambientit dhe infrastrukturës, grupi i të rinjve ka identifikuar prioritetet në vijim që kërkojnë zgjidhje dhe trajtim nga ana e autoriteteve lokale: Deponia e mbeturinave në lagjen Gërlicë paraqet problem për banorët e lagjes. Është vend shumë i papërshtatshëm dhe për pasojë ka shumë qenë endacak përreth deponisë. Mungesa e shportave të mjaftueshme për mbeturina nëpër pjesët e qytetit dhe mungesa e pastrimit të rrugëve në qytet janë një problem tjetër që ballafaqojnë qytetarët e komunës.

Mungesa e hapësirave gjelbëruese në qytet. Nxënësit dhe studentët nga fshatrat përballen me problemin e transportit. Mungesa e shenjave të mjaftueshme të komunikacionit nëpër rrugë. Mungesa e hapësirave për parkingje në qytet.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet lokale të adresojnë me prioritet çështjen e mbeturinave. Duhet të ndryshohet vendi i deponisë dhe e njëjta duhet të vendoset në hapësirë ku nuk shkakton probleme shtesë për qytetarët.



**2** Po ashtu, duhet të shtohet numri i shportave për mbeturina në qytet dhe njëkohësisht të bëhet një fushatë vetëdijësuese për rëndësinë e hedhjes së mbeturinave në vendin e duhur. Njëkohësisht, një aktivitet me angazhim të inspektorëve komunal për një periudhë të caktuar kohore do të shërbente si “masë disiplinuese” për qytetarët e pandërgjegjshëm. Pastrimi sistematik i rrugëve të qytetit është masë tjetër që do të ndikonte në përmirësimin e ambientit në qytet.


**3** Krijimi i hapësirave të gjelbra në qytet duhet të jetë prioritet tjetër i autoriteteve lokale. Aktualisht, ka mungesë të theksuar të hapësirave të tilla në qytet.

**4** Sigurimi i transportit për nxënës dhe student nga viset rurale duhet po ashtu të trajtohet me prioritet nga autoritetet lokale. Një marrëveshje me ndonjë operator privat ose formë tjetër për ulje të çmimit të biletave do të ishte lehtësim i madh për këtë kategori të qytetarëve.

**5** Autoritetet lokale duhet të trajtojnë mungesën e shenjave të mjaftueshme nëpër rrugë dhe të vendosin ato me prioritet me qëllim të përmirësimit të gjendjes në trafik.

**6** Edhe krijimi i hapësirave për parking në qytet duhet të adresohet dhe të zgjidhet nga autoritetet lokale sepse mungesa e tyre paraqet problem shumë serioz për qytetarët.





## Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

ADELINA IDRIZI

ELIRJETA BISLIMI

JETMIRE IBRAHIMI

ALBERT UKSHINI

ELITË BARDHI

LEONORA SHALA

ALBION RUSHITI

ELONA SAHITI

PARIS GURI

ARDITA BEQIRI

ERMIRA MEHMETI

RIANDA UKSHINI

ARLIND SHABANI

FATIME ALIU

RINOR SHEFKIU

BAJRUSH RRAHMANI

FLANDRA SHALA

SHQIPRON XHEMA

DIANA LUZHA

FLORIAN QERIMI

VALDRINA SALIHU

DORENTINA MEHMETI

FLORIE BERISHA


VJOLLCA LUZHA

ELIRA TAHIRI


GOJARTA GRAINCA







**Duke pasur parasysh kufizimet  
buxhetore si dhe problemet që  
ballafaqojnë komunat në procesin  
e hartimit të buxheteve komunale,  
diskutimi dhe puna e grupeve të të  
rinjve është orientuar në identifikimin  
e çështjeve që janë të prekshme,  
të zbatueshme dhe që në pjesën  
më të madhe nuk kanë implikime  
të mëdha buxhetore.**



 KOSOVA  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina